



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:068522

Datë: 09.02.2024

Numri i dokumentit: 05306591

Ac.nr.3384/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Nehat Idrizi dhe Burim Shala, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit H.B., nga fshati G....., Komuna e Malishevës, tani me vendbanim në Prizren, Rr. “I... B.....” p.nr, kundër të paditurit K.D., nga Prizreni, me vendbanim në lagjen A....., në Rr. “B..... e P.....” p.nr, të cilin me autorizim e përfaqëson A.Sh., avokat në Prizren, në çështjen për pengim posedimi, duke vendosur sipas ankesës së autorizuarit të paditësit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1218/2022 të datës 09.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e paditësit H.B., nga fshati G....., Komuna e Malishevës, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1218/2022 i datës 09.03.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar, C.nr.1218/2022 të datës 09.03.2023, në pikën një të dispozitivit ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit H.B., nga fshati G....., Komuna e Malishevës, tani me vendbanim në Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se i padituri K.D., ka penguar në posedimin e lirë të shtëpisë dhe ngastrës së paditësit, duke e privuar atë në mënyrë të kundërligjshme nga posedimi i pronës së paluajtshme, asisoj që në kufirin mes ngastrës së tij dhe ngastrës kadastrale P-XXX-XXX-X, ZK Dushanovë, në vendin e quajtur “Q..../i.... p....”, respektivisht pjesës në sipërfaqe prej 814 m², ka ndryshuar

rrjedhën e ujit e cila gjatë reshjeve atmosferike rrjedh përgjatë pronës së paditësit dhe kalon nëpër kufirin e ngastrës së të paditurit, ku me veprimin e tij ka bllokuar këtë rrjedhë dhe për pasojë shtëpia e paditësit me datë 20.05.2020, është vërshuar nga ujërat e grumbulluara nga shiu duke shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale, si dhe të detyrohet i padituri K.D., që brenda 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi të bëjë kthimin në gjendjen e mëparshme të pjesës kontestuese, pra të heq pengesën për pengim posedim dhe të lejon rrjedhjen natyrale të ujit nëpër kufirin e pronës së tij pa e penguar atë, në atë mënyrë që të largojë sasinë e deponuar të dheut dhe të vendos gypat për kalimin e lirë të rrjedhës së ujit, si dhe të detyrohet i padituri t'i paguajë shpenzimet procedurale me 15 ditë pas plotfuqishmërinë e këtij aktvendimi nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm. Në pikën dy e ka detyruar paditësin H.B., që t'ia paguan paditurit shpenzimet e procedurës dhe atë në lartësi prej 405 Euro, brenda afatit 7 ditor nga dita e pranimit të këtij aktvendimi , e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i paditësit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shpenzimeve procedurale, me propozim që Gjykata e Apelit, të aprovoj ankesën e paditësit si të bazuar, të ndryshoj aktvendimin ankimor, ashtu që ta aprovoj në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, dhe të obligohet i padituri t'i kompensoj shpenzimet e procedurës.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

- Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi ka ushtruar padi ndaj të paditurit për pengim posedimi. Duke vepruar sipas padisë, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën gjyqësore pas administrimit dhe shqyrtimit të provave, me aktvendimin C.nr.769/20 të datës 03.12.2020, e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit. Gjykata e Apelit me aktvendimin Ac.nr.855/21 të datës 10.03.2022, e ka aprovuar ankesën e paditësit dhe çështjen e ka kthyer në procedim të serishëm, me vërejtjen që gjykata të vërtetoj gjendjen faktike të çështjes si dhe afatshmërinë e pengimit të posedimit.

Në riprocedurë, gjykata e shkallës së parë duke vepruar konform sugjerimeve të gjykatës ankimore, ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor, pas dëgjimit të paditësit dhe të paditurit në cilësi të palëve dhe administrimit të provave të tjera që gjenden në shkresa të lëndës ka marrë aktvendimin C.nr.1218/22 të datës 09.03.2023, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit ankimor.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit, për arsye se aktvendimi i atakuar

nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së dhe nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare konform nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që dispozitivi i aktvendimit është i qartë dhe i kuptueshëm dhe i hartuar në përputhje të plotë me dispozitën e nenit 160, lidhur me nenin 175 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK). Në anën tjetër, rezulton se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore, duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendosë si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë. Po ashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në mes të arsyeve të paraqitura nuk ekzistojnë kundërthënie, ndërsa nuk ka as në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktvendimit.

Gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës ankuese as për këtë bazë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar. Andaj pretendimet mbi këtë bazë, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë, për arsye se gjykata e shkallës së parë, i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në procedurën për shkak të pengim posedimit si objekt shqyrtimit është mbrojtja e posedimit nga marrja dhe shqetësimi si dhe rivendosja e gjendjes së posedimit. Kjo do të thotë se me padi për pengim posedim mbajtësi faktik i sendit mund të kërkojë nga gjykata që të vërtetojë ekzistimin e aktit të pengim posedimit të sendit apo të së drejtës, që ta urdhërojë të paditurin që të rivendosë gjendjen e posedimit, ashtu siç ka qenë para kryerjes së aktit të pengim posedimit dhe ti ndalojë të paditurit ndërmarrjen e veprimit të njëjtë apo të ngjashëm në të ardhmen. Në rastin konkret, paditësi nuk ka argumentuar se si i padituri i ka shkaktuar pengimin e posedimit në cilëndo mënyrë të shfrytëzimit të palujtshmërisë së tij për periudhën e cekur si në padi dhe sipas kërkesëpadiës së precizuar, sepse nga provat në shkresë të lëndës e sidomos nga ekspertiza e gjeodezisë është vërtetuar se i padituri në palujtshmërinë e tij ng.kad.nr.XX-X, në vendin e quajtur ‘Q..... - te rruga’, ZK D....., e cila evidentohet bashkëpronësi, me X/XX pjesë ideale në emër të paditurit K.D., ka hedhur dheun në lartësi prej 1.6 m, dhe në këtë mënyrë ka bërë rrafshimin e sipërfaqes së palujtshmërisë së tij. Në kuptim të lartcekurve rezultoi se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur si të pa themeltë bazueshmërinë e kërkesëpadiës.

Duke marrë parasysh të lartcekurat, Gjykata e Apelit i refuzoi si të pabazuara pretendimet ankimore të palës paditëse të theksuara në ankesën e parashtruar, ku përveç që paditësi nuk ka ofruar ndonjë bazë mbi të cilën Gjykata e Apelit do të vendoste ndryshe nga ajo që ka vendosur gjykata e shkallës së parë, e njëjta, edhe për ato shkelje që i ka pretenduar, nuk ka dhënë sqarime të mjaftueshme, duke e bërë kështu ankesën të mangët.

Meqë aktvendimi i atakuar është vërtetuar në tërësi, automatikisht vërtetohet edhe vendimi mbi shpenzimet procedurale, për të cilin gjykata, me të drejtë, është mbështetur në nenin 452, të LPK-së.

Gjykata e Apelit i mori parasysh edhe të gjitha pretendimet të tjera ankimore të palës paditëse, por të njëjtat nuk patën ndikim në vendosjen ndryshe nga kjo që është vendosur.

Nga sa u tha me lartë u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3384/23, me datë 06.02.2024

Kryetarja e kolegjit
Naime Ahmeti d.v